REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës Vlada Kosova Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref.Nr. 1207/2011
Data 13.06-2011
Nënshkrimi
Potpis
Signature
PRISHTINË, PRIŠTINA, PRISHTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURU, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE ,YOUTH AND SPORTS

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

ndërmjet

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

dhe

Fondacionit të Galerisë Agim Qavdarbasha

Prishtinë, 09/06/2011

Neni 1

Minstria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Fondacioni i Galerisë Agim Qavdarbasha janë pajtuar për implementimin e projektit kapital, renovimin e Galerisë Agim Qavdarbasha në Çagllavicë, e dëmtuar gjatë muajit mars 2004.

Neni 2

Ky Memorandum i Mirëkuptimit lidhet ndërmjet palëve nënshkruese: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në vazhdim MKRS) dhe Fondacionit të Galerisë Agim Qavdarbasha.

Neni 3

Qëllimi i këtij Memorandumi është implementimi i projektit-zbatimi i punimeve për rekonstruimin dhe renovimin e Galerisë Agim Qavdarbasha në Çagllavicë.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha fazave të punës dhe aktiviteteve lidhur me projektin e lart theksuar.

Palët pajtohen për obligimet dhe përgjegjësitë themelore lidhur me implementimin e suksesshëm të projektit dhe në veçanti mbi përdorimin e drejtë të burimeve financiare.

MKRS do të emërojë një mbikëqyrës të zbatimit të punimeve, i cili do të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesit e Fondacionit Agim Qavdarbasha.

MKRS dhe Fondacioni Agim Qavdarbasha bashkërisht do të definojnë dhe propozojnë edhe objektivat tjera të nevojshme që kanë të bëjnë me implementimin e projektit.

Neni 5

MKRS këtë projekt e financon në vlerë prej 24.601 euro, respektivsht kjo shumë i transferohet Fondacionit Agim Qavdarbasha për zbatim të projektit.

Neni 6

Fondacioni Agim Qavdarbasha për implementimin e projektit i raporton MKRS-së përmes mbikëqyrësit, raporteve mujore të punës dhe atyre financiare.

Neni 7

Palët pajtohen, që kur është e nevojshme dhe e obligueshme me ligj, të zbatojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit ashtu siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik, të aplikueshëm në Kosovë.

Neni 8

Ne rast të moszbatimit të pikave të këtij Memorandumi nga ndonjëra palë, Memorandumi mund të ndërpritet brenda periudhës dymujore.

Ndërprerja e Memorandumit bëhet përmes njoftimit me shkrim për palën tjetër, me një dëshmi të pranimit të këtij njoftimi.

Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ngjarjeve të "fuqisë mbinatyrore" dhe rrethanave tjera të paparashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante, për veprimet e mundshme që duhet ndërmarrë.

Neni 9

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) dokumente origjinale në gjuhën shqipe.

Për ndryshimet e mundshme eventuale, palët do të pajtohen gjithmonë duke u bazuar në këtë Memorandum.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje kompetente është Gjykata Komunale në Prishtinë.

Neni 10

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët nënshkruese.

P a l ë t n ë n sh k r u e s e

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm

Veton Firzi

Fondacioni Agim Qavdarbasha

Sebahate Qavdarbasha

S. Qavdarbasha